



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 0473, Datë 26. 05 . 2026

**PËR**

**MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIT PËR 4 MUJORINE PARË TË VITIT 2026**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27. 04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë Lezhë;

**Për të vendosur:**

1. Miratimin e Buxhetit Faktit për 4 mujorin e parë të vitit 2026, sipas relacionit dhe pasqyrave përkatëse, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Nr. 8473/1 Prot.

Lezhë, më 26. 05 . 2026

**RELACION**

**LIDHUR ME PROJEKTVEKNDIMIN E PARAQITUR PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK PËR 4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2026**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; ju paraqesim projektvendimin për realizimin e Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2026 për shqyrtim dhe miratim nga ana Juaj.

Lidhur me realizimin e Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2026, relatoj si më poshtë:

- Të ardhurat nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore janë realizuar 27.9% ose 373,988.6 mijë lekë më pak se plani, respektivisht sipas burimeve janë: Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar 20.9% ose 251,824 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 82.9% ose 5,140.2 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat nga tarifatat vendore janë realizuar 46.4% ose 56,238.2 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat e tjera janë realizuar 7 % ose 60,786.2 mijë lekë më pak se plani. Në raport me të njëjtën periudhë të vitit kaluar të ardhurat janë realizuar 111.7% ose 15,136.5 mijë lekë më shumë.

- Shpenzimet janë realizuar 37.3% ose 696,600.2 mijë lekë më pak se plani, respektivisht, Shpenzimet korrente janë realizuar 55.8% ose 301,580.8 mijë lekë më pak se plani dhe shpenzimet kapitale (investimet) janë realizuar 7.3% ose 395,019.4 mijë lekë më pak se plani. Në mënyrë të detajuar të dhënat e zbatimit të Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2025, jepen në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e parë, bashkëlidhur projektvendimit. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu

